



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 22.05.2013
Nr. 0204-616

PËR: Shukri Buja, Kryetar i Komunës së Lipjanit
Lulzim Rrustemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT,
15Nr.464-6414, Pranuar me datë, 07.05.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 15Nr.464-6414, të miratuar me datë 30.04.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 15 Nr.464-6414, për Dhënien në Shfrytëzim të Tokës-Pasuri Shoqërore e KK Lipjan, në ZK Medvec për Riintegrimin e Përsoneve të Riatdhesuar.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 22.05.2013
br. 0204-616

Za: Shukri Buja, Gradonačelnik Opštine Lipljane
Ljiljym Rustemi, Predsedavajući Skupštine Opštine Lipljane

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE LIPLAJNE
,15 Br. 646-6414, Primiteno dana, 07.05.2013

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke 15Br.464-6414 usvojene dana 30.04.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt navaden u nastavku, ima puni pravni efekat .

- Odluka 15Br. 464-6414 , za davanje na korišćenje zamljišta društvene imovine vlasništvo SO Lipljane,u ZK Medvec za Reintergraciju Lica Povratnika.


S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, Rregullores Nr.10/2012 për Menagjimin e Programit, Organet Kompetente, Procedurat dhe Kriteret e Përfitimt për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, nenit 5 të Ligjit për Planifikim Hapësinor të Kosovës Nr.2003/14, nenit 9 shkronja (b) dhe nenit 17, 20, 20.1 shkronja (d) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 30. 04. 2013, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit miratoië këtë:

VENDIM

PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN, NË ZK MEDVEC PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR

Neni 1

Me këtë Vendim, Komuna e Lipjanit e jep në shfrytëzim, sipërfaqen prej 3000m² nga ngastra kadastrale P-71409055-00016-0 Lloji i njësisë-parcelë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.45,18 ha, në vendin e qujtur "Breg", lloji i shfrytëzimit të parcelës-bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës-kullosë, klasa e kualitetit kullosë i kl. të 2-të e evidentuar në Certifikatën 14-2694 ZK Medvec, P.Sh. Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Sipërfaqja prej 3000m² e cila ipet në shfrytëzim ka për destinim për realizim të projektit planifikimit dhe implementimit të Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar-banim individual dhe si e tillë nuk mund të shfrytëzohet për qëllime tjera, kurse titullar i saj mbetet Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 3

Me këtë Vendim sipërfaqja e cila ipet në shfrytëzim duhet të parcelohet në pesë (5) troje me 300m² të tipit në varg, kurse trolli tjetër i mbetur me sipërfaqe prej 1500m² dedikohet për raste tjera.

Neni 4

Me këtë Vendim autorizohet Komisioni Komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar i formuar me Vendimin e Kryetarit të Komunës 1Nr.031-7603 i dt.18.06.2012, ta bënë përzgjedhjen e rasteve për riatdhesim të cilët do të jenë përfitues potencial për shfrytëzim të këtyre trojeve. Përfituesit potencial të këtyre trojeve pronën komunale do ta shfrytëzojnë si nikoqir të mirë dhe me mirëbesim, nuk mund të ia japin personit të tretë në shfrytëzim, nuk mund të tjetërsojnë. Prona e dhënë në shfrytëzim nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkes tjetër. Kushtet urbanistike-teknike si pjesë e procesit të procedurës së implementimit të projektit që parashifen me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit do të definohen në harmoni me Projektin Ideor, planet rurale për këtë zonë dhe kushteve ekzistuese në parcelë, me qëllim të krijimit të zonës si tërësi funksionale për këtë qëllim.

21.05.2013

Neni 5

Të gjitha procedurat që rrjedhin nga procesi i Lejes Ndërtimore, që rezultojnë në përmbyshjen e kushteve për kompletimin e dokumentacionit teknik do të kujdeset Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Obligohet DGJK-Sektori për kadastër dhe gjeodezi, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit në librat publike, P.Sh.KK Lipjan PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR-shfrytëzues _____.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Komisioni Komunal për riintegrimin e personave të riatdhësuar i formuar me Vendimin e Kryetarit të Komunës 1Nr.031-7603 i dt.18.06.2012.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi tetë ditë (8) pas publikimit në webfaqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

15 Nr. 464-~~64~~14
Lipjan, me 03. 05. 2013

KUVENDI KOMUNAL LIPJAN



Kryesuesi
Lulzim Rrustemi